

Emri i Lëndës : Vlerësimi i të Nxënit në AMU							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EDU 424	B	Pranverë	2.00	2.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Albana Cekrezi, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Ky kurs ofron njohuri rreth përdorimit të praktikave dhe strategjive të vlerësimit për të përmirësuar të nxënit e studentëve. Theks i veçantë do t'i kushtohet vlerësimit autentik, praktikave, testeve të standardizuara dhe shqyrtimeve zhvillimore. Për më tepër, studentët do familjarizohen me masat për të vlerësuar nxënësit me nevoja të veçanta, ata me prirje të ndryshme, dhe nxënësit me prejardhje të shumëllojshme gjuhësore dhe kulturore.					
Objektivat		Me anë të këtij kursi studentët do të kuptojnë rëndësinë e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive. Do të mësojnë kriteret për zhvillimin e formave cilësore dhe të besueshme të vlerësimit, dhe jo vetem testeve. Me anë të këtij kursi studentët do të kuptojnë rëndësinë e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive, aftësive dhe kompetencave. Do të mësojnë kriteret për zhvillimin e formave cilësore dhe të besueshme të vlerësimit, dhe jo vete. Do të njihen me parimet kryesore që mundësojnë formimin e një forme të vlerësimit sa më efektive. Do të njihen me karakteristikat e testeve të standardizuara. Do të njihen me forma të reja të vlerësimit të gjuhës së huaj përtej testeve. Do të gjykojnë mbi mënyrën e vlerësimit sipas formave të ndryshme të inteligjencës.					
Konceptet Kryesore		1. Vlerësim i gjuhës 2. Teste të standartizuara 3. Aftësi gjuhësore 4. Variante të vlerësimit 5. Vlerësim i besueshëm 6. Parime të vlerësimit					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në kurs: Shpjegimi i planprogramit. Shpjegime rreth tekstit/librit dhe materialeve të tjera. Shpjegim rreth organizimit të kursit në përgjithësi.						
2	Lidhja mes vlerësimit dhe të nxënit. Rolet dhe qëllimet e vlerësimit. Rëndësia e vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Vendi dhe roli i vlerësimit të të nxënit. Qëllimi dhe objektivat e të nxënit. Llojet e vlerësimit. Hapësira që zë testimi në vlerësimin e të nxënit. Vlerësimi formal dhe informal, formues dhe përfundimtar.						
3	Përjasje në testimin e gjuhës: Një histori e shkurtër. Vlerësimi i gjuhës historikisht ka qenë në një linjë me metodologjinë e mësimdhënies. Përjasjet në testimin e gjuhës: Testimi integruar, testimi komunikativ, vlerësimi bazuar në performancë.						
4	Ndikimet në vlerësimin e të nxënit. Teoritë e inteligjencës, rritja e popullaritetit të testimit kompjuterik, vlerësimi alternativ. Arritja e një vlerësimi efektiv. Vlerësimi në baze të llojeve të ndryshme të inteligjencës, inteligjenca linguistike, matematikore, muzikore, hapësinore, emocionale etj. Ndikimi i tyre në përgatitjen e vlerësimit. Ndikimi i vlerësimit kompjuterik. Vlerësimi tradicional dhe vlerësimi alternativ. Ndryshimet dhe ngjasitë mes tyre.						
5	Vlerësimi i objektiveve mësimore. Taksonomia e Bloom-it, aplikimi i taksonomisë. Vlerësimi i nxënësve të rinj.						
6	Parime në Vlerësimin e Gjuhës. Pesë parimet kryesore të vlerësimit të të nxënit: prakticiteti, besueshmëria, vlefshmëria, autenticiteti dhe wash-back. Elementët që ndikojnë në prakticitetin e një forme vlerësimi: koha, paratë dhe burimet njerëzore. Besueshmëria e formave të vlerësimit, e ambientit, e vlerësuesit. Llojet e ndryshme të vlefshmërisë. Originaliteti i formave të vlerësimit dhe rëndësia e tyre për nxënësin.						

7	Aplikimi i parimeve të vlerësimit të gjuhës. Hartimi i testimit në klasë, dhënia e feedback. Vlerësimi i formave të ndryshme të vlerësimit mbi skenare të ndryshme, vlerësimi sipas praktikitetit, besueshmërisë, vlefshmërisë, autenticitetit dhe washbash.
8	Provimi gjysmëfinal
9	Vlerësimi i aftësive gjuhësore: vlerësimi i të folurit në nivel mikro dhe makro. Aftësitë klasifikohen në dy kategori të rëndësishme: ato me performancë receptive, marrëse dhe ato prodhuese. Niveli mikro në aftësinë e të folurit ka të bëjë me prodhimin e pjesëve të vogla të gjuhës si fonema, morfema, fjalë etj. Niveli macro nënkupton elementë si rrjedhshmëria, diskursi, funksioni, stili, dhe komunikimi jo-verbal. Gjithashtu vlerësimi i aftësisë së të folurit realizohet mbi pesë lloje të të folurit: imitues, intensive, përgjigjës, ndërveprues dhe i zgjeruar.
10	Vlerësimi i aftësive gjuhësore: vlerësimi i të lexuarit. Llojet e të lexuarit. Bottom-up përfshin leximin dhe kuptimin duke filluar nga niveli i fjalës deri në diskurs. Top-down përfshin të kundërtën. Vlerësimi formues dhe përmbledhës i të lexuarit. Llojet e teksteve të leximit: akademik, të lidhura me punën dhe ato personale. Aftësitë makro përfshijnë zhvillimi dhe përdorimi i strategjive në lexim si: skimming, scanning, dallimi i përcaktuesve të ligjëratës.
11	Vlerësimi i aftësive gjuhësore: vlerësimi i të dëgjuarit: në nivel mikro dhe makro. Aftësia e të dëgjuarit ka rëndësi pasi cilësia e të folurit varet nga cilësia e të dëgjuarit. Të dëgjuarit është aftësi marrëse dhe vlerësimi i tij kërkon disa matje. Vlerësimi i të dëgjuarit duhet bërë pasi dhe vëzhgimi i procesit të të dëgjuarit dhe produkti janë të padukshëm. Dëgjimi klasifikohet në katër lloje: intensiv, përgjigjës, selektiv, dhe i zgjeruar. Aftësitë mikro kanë të bëjnë me copëza të vogla të gjuhës si kuptimi i formave të reduktuara gjatë dëgjimit. Aftësitë makro kanë në fokus elementë më të gjerë të gjuhës si: zhvillimi i strategjive të dëgjimit si dallimi i fjalëve kyc ose kuptimi i fjalëve nga konteksti.
12	Vlerësimi i të shkruarit. Llojet e gjuhës së shkruar janë shkrimi akademik, shkrimi për çështje pune dhe shkrimi personal. Llojet e performancës së shkruar: imituese, intensive, përgjigjëse, dhe e zgjeruar.
13	Vlerësimi i të shkruarit. Disa mikro aftësi të të shkruarit përfshijnë prodhimin e fjalëve bazë, përdorimi i rendit të duhur të fjalëve. Makro aftësitë përfshijnë dallimin mes kuptimit të drejtpërdrejtë dhe nënkuptuar gjatë shkrimit, transmetimi i lidhjeve mes idesë kryesore, ideve mbështetëse, njohuri të reja, përgjithësime dhe dhënia e shembujve. Vlerësimi i të shkruarit realizohet në bazë të të dhënave të mësipërme.
14	Përtej Testimit. Variante të Vlerësimit: Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol, prezantim me gojë ose punë me shkrim, projekt kurrikular etj.
15	Vendosja e notave dhe Vlerësimi i Nxënësve: -Mësuesi së bashku me nxënësit përcaktojnë kriteret për vlerësimin e projektit të cilat i komunikohen nxënësit që në fillim të projektit. P.sh. kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes, në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj.,(në varësi të rezultateve të të nxënësit.)
16	Provimi final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Lee Dunn, Meg O'Reilly, Sharon Parry, Chris Morgan, The student's Assessment Handbook, Routledge Falmer, 2004 • Popham, James W. (2011) Classroom Assessment: What Teachers Need to Know, 6th Edition, Allyn & Bacon, Boston, MA. • Brown, Douglas, H.: Language Assessment: Principles and Classroom Practices, Longman, 2003
Referenca të tjera	• Stiggins, R. & Chappuis, J. (2008), "Enhancing Student Learning: Create profound achievement gains through formative assessments", The District Administrator. • Stiggins, R. & Chappuis, J. (2005), "Using student-involved classroom assessment to close achievement gaps", Theory Into Practice, 44(1), 11-18.
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë në gjendje të përdorin një gamë të gjerë të masave të vlerësimit dhe të zbatojnë ato të përshtatshme.
2	Studentët do të përgatisin forma vlerësimi formale dhe jo formale.
3	Studentët do të reflektojnë mbi rëndësinë dhe politikat e sotme të vlerësimit në arsim.
4	Studentët do të jenë të aftë të përdorin një gamë të gjerë të mikro dhe makro aftësive për: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit.
5	Studentët do të peshojnë avantazhet e disavantazhet e vlerësimit online.
6	Studentët do të mësojnë të ndërtojnë forma vlerësimi sipas standardeve të vlerësimit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	20	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	6	84
Detyra	1	1	1
Gjysmë finale	1	1	1
Provimi final	1	1	1
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			151
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.04
ECTS			6.00